



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

DATË/A:	15.02.2023
REFERENCË:	NR. 02-060/01-0000937-4A/23
PËR/ZA/TO:	Vesa Broja - Kryesuese e Kuvendit të Komunës Z. Bedri Hamza – Kryetar i Komunës
CC:	Anëtarët e Kuvendit të Komunës
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Nazmi Jashari – Udhëheqës i Sekretarisë së Kuvendit
NGA/OD/FROM:	Grupi punues për hartimin e Planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2022
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raport nga konsultimi me publikun për Planin e punës së Kuvendit për vitin 2023



Hyrje

Duke u bazuar në nenin 68, paragrafi 68.3, të Ligjit për vetëqeverisje lokale; nenin 93 të Statutit të Komunës së Mitrovicës; nenin 14, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5, të Rregullores (MAPL) Nr. 02/2021 Për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës; nenin 3 paragrafi 5, nenin 6 dhe nenin 7, paragrafi 1.3, të Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2018 Për standardet minimale të konsultimit publik në komuna, me qëllim të nxitjes dhe sigurimit të pjesëmarrjes së qytetarëve dhe palëve të tjera gjatë procesit të politikëbërjes dhe vendimmarrjes në Kuvendin e Komunës së Mitrovicës; Komuna e Mitrovicës ka shpall diskutimin publik për Planin e punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2023, për datën 10.02.2023, në Sallën e Kuvendit të Komunës, duke filluar nga ora 14:00.

Ecuria e procesit

Sekretaria e Kuvendit në harmoni me Ligjin për vetëqeverisje lokale dhe dispozitat e Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2018 Për standardet minimale të konsultimit publik në komuna ka publikuar njoftimin për konsultim publik të Planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2022 në ueb faqen e Komunës dy javë para mbajtjes së takimit në <https://kk.rks-gov.net/mitroviceejugut/wp-content/uploads/sites/18/2023/02/Diskutim-Publik-per-planin-e-punes-per-vitin-2023.pdf> dhe në rrjetet sociale të Komunës, po ashtu njoftimi është vendosur edhe në hyrje të objektit të Komunës.

Njoftimi për konsultim publik është shpallë në afatin e paraparë ligjor, respektivisht nenin 16 të Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2018 Për standardet minimale të konsultimit publik në komuna, duke u interesuar që të sigurohet njoftim i plotë dhe i duhur për palët e interesuara. Me ftesën për konsultim publik palët e interesuar janë njoftuar me datën, vendin

dhe kohën e mbajtjes së takimit publik. Njoftimit i është bashkangjitur Drafti i Planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2023, që ka qenë objekt i konsultimit publik, shpjegime shtesë, si dhe informatat për personin përgjegjës për pranimin e komenteve.

Metodat e Konsultimit	Datat/kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve/kontribuuesve
1. Konsultimet me shkrim/në mënyrë elektronike	14 ditë	0
2. Publikimi në ueb faqe	14 ditë para mbajtjes së takimit kryesor	14

Në konsultim publik për Planin e punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2023 kanë marrë pjesë: znj. Vesa Broja, Kryesuese e Kuvendit të Komunës, Sekretaria e Kuvendit, Kryetari i Grupit punues për hartimin e Planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2023, drejtorë të drejtorive dhe Zyra për Informim.

Nuk ka pasur pjesëmarrës tjerë.

Vlen të theksohet se Sekretaria e Kuvendit nuk ka marrë asnjë vërejtje apo sugjerim me shkrim apo formë tjetër nga ana e publikut gjatë afatit kohor të përcaktuar me Udhëzimin Administrativ Nr. 06/2018.

SHTOJCË: *Lista e pjesëmarrësve në diskutim publik*



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica - Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT
Grupi Punues për hartimin e Planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2023
Dt. 10.02.2023
Mitrovicë

DISKUTIM PUBLIK
PËR PLANIN E PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2023

Lista e pjesëmarrjes:

Nr.	Emri e Mbiemri	Data	Nënshkrimi
1.	Veseli Naliri	10.02.2023	
2.	NAZMI JASHARI	10.02.2023	
3.	Gazdan Stavileci	10.02.2023	
4.	Merita Rakuca	10.02.2023	
5.	Dlerina Kastrioti Idriza	10.02.2023	
6.	Sofije Dushiti Peci	10.02.2023	
7.	AMIR KELMENDI	10.02.2023	
8.	Liridona Muharremi	10.02.2023	
9.	Merita Maxhori	10.02.2023	
10.	Vesa Broja	10.02.2023	
11.	Ariona Ruzhita	10.02.2023	
12.	Valdete Idriza	10.02.2023	
13.	Arden HASHA	10.02.2023	
14.	EGZON SADIKU	10.02.2023	
15.		10.02.2023	
16.		10.02.2023	
17.		10.02.2023	
18.		10.02.2023	
19.		10.02.2023	
20.		10.02.2023	
21.		10.02.2023	
22.		10.02.2023	
23.		10.02.2023	
24.		10.02.2023	
25.		10.02.2023	



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT
Grupi Punues për hartimin e Planit të punës së Kuvendit për vitin 2023
Mitrovicë

DATË/A:	02.02.2023
REFERENCË:	Nr. 02-060/01- 0000937-2/23
PËR/ZA/TO:	Vesa Broja - Kryesuese e Kuvendit të Komunës
CC:	Z. Bedri Hamza – Kryetar i Komunës
NGA/OD/FROM:	Vesel Neziri – Kryetar i Grupit Punues për hartimin e Planit të punës së Kuvendit për vitin 2023
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Shpallja e diskutimit publik

Me qellim të nxitjes dhe sigurimit të pjesëmarrjes së qytetarëve dhe palëve të tjera gjatë procesit të politikë bërjes dhe vendimmarrjes në Kuvendin e Komunës së Mitrovicës, duke u bazuar në nenin 68, paragrafi 68.3, të Ligjit për vetëqeverisje lokale; nenin 93 të Statutit të Komunës së Mitrovicës; nenin 14, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5, të Rregullores (MAPL) Nr. 02/2021 Për procedurën e hartimit dhe publikimit të akteve të komunës; nenin 3 paragrafi 5, nenin 6 dhe nenin 7, paragrafi 1.3, të UA Nr. 06/2018 Për standardet minimale të konsultimit publik në komuna, Komuna shpallë:

DISKUTIM PUBLIK

Për Planin e punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2023

Njoftohen të gjithë qytetarët, grupet e interesit dhe palët tjera të interesuara që të marrin pjesë në debatin publik, i cili do të mbahet ditën e **premtë**, datë **10.02.2023**, në Sallën e Kuvendit të Komunës, duke filluar nga **14:00**.

Duke pasur në konsideratë rëndësinë e Planit të punës së Kuvendit, pjesëmarrja e publikut në këtë fazë të procesit është e domosdoshme, prandaj qytetarët dhe të interesuarit e tjerë nga dita e publikimit të këtij njoftimi, të gjitha komentet, vërejtjet, sugjerimet dhe pikëpamjet mund t'i japin përmes e-mail adresës elektronike të Komunës së Mitrovicës komuna.mitrovica@gmail.com ose drejtpërdrejt në Sekretarinë e Kuvendit të Komunës tek Udhëheqësi i Sekretarisë z. Nazmi Jashari (e-mail: nazmi.jashari@rks-gov.net).

Bashkangjitur gjeni Draft-Planin e punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2023 të miratuar nga Grupi punues për hartimin e Planit të punës së Kuvendit për vitin 2023, i formuar me vendim të Kuvendit të Komunës.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT
Nr. 02-060/01-0000937-5/23 DT. 20.02.2023
Mitrovicë

PLANI I PUNËS
SË KUVENDIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2023



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT
Nr. 02-060/01-0000937-5/23 DT. 20.02.2023
Mitrovicë

PLANI I PUNËS
SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË MITROVICËS PËR VITIN 2023

Pasqyra e planit

Parathënie.....	2
Përfundim.....	3
Janar.....	5
Shkurt.....	6
Mars.....	7
Prill.....	8
Maj.....	9
Qershor.....	10
Korrik.....	11
Gusht.....	12
Shtator.....	13
Tetor.....	14
Nentor.....	15
Dhjetor.....	16

Parathënie

Kuvendi i Komunës është organi më i lartë në Komunë dhe zgjidhet drejtpërdrejt nga qytetarët, dhe funksionon në bazë të Ligjit për vetëqeverisje lokale, Statutit dhe akteve të tjera nënligjore.

Kuvendi i Komunës nuk i delegon përgjegjësitë e tij lidhur me marrjen e vendimeve për:

- Statutin dhe Rregulloren e punës së kuvendit të komunës, rregulloret komunale dhe miratimin, ndryshimin dhe shfuqizimin e tyre;
- Miratimin e buxhetit dhe planeve investuese;
- Miratimin e çështjeve të tjera financiare, të cilat janë të rezervuara për Kuvendin sipas statutit apo Rregullores së punës;
- Planin vjetor të punës dhe raportin vjetor;
- Themelimin e komisioneve të kërkuara sipas Ligjit;
- Nivelin e tarifave dhe ngarkesave;
- Krijimin dhe përdorimin e simboleve, dekoratave dhe titujve të nderit të Komunës, në pajtim me ligjin në fuqi;
- Emërimin dhe rrimërimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike;
- Arritjen e marrëveshjeve ndërkomunale dhe brenda komunale;
- Marrjen e vendimeve për t'u bashkuar me asociacione përfaqësuese të komunave të Republikës së Kosovës; dhe
- Përgjegjësi të tjera që kërkohen me ligj.

Qeverisja e mirë lokale nuk nënkupton vetëm ofrimin e shërbimeve publike, por gjithashtu mbrojtjen e lirive të banorëve lokalë, krijimin e hapësirave për pjesëmarrje demokratike dhe respektim të parimeve të sundimit të ligjit. Në këtë drejtim Kuvendi i Komunës respektivisht Komuna duhet të jenë të kujdesshme në përgatitjen e legjislacionit që është në përputhje me të drejtat e njeriut, i hartuar mirë dhe konform standardeve demokratike. Veç kësaj, ky legjislacion duhet gjithashtu të vihet në dispozicion të publikut. Për marrjen e vendimeve, Kuvendi i Komunës mund t'ia delegojë pushtetin e tij komiteteve të përhershme të Kuvendit të Komunës, apo Kryetarit të Komunës. Kuvendi i Komunës mund të tërheqë delegimin në çdo kohë.

Komiteti për Politikë dhe Financa është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave, duke përfshirë dokumentet e planifikimit strategjik, Kornizën vjetore buxhetore afatmesme, planin vjetor të prokurimit, rregulloren vjetore për tatimet, tarifat dhe pagesat, planin vjetor të punës për auditimin e brendshëm, buxhetin vjetor afatmesëm dhe çdo ndryshim të buxhetit gjatë vitit fiskal si dhe për marrjen e raporteve nga kryetari dhe dorëzimin e rekomandimeve në Kuvendin e Komunës.

Kuvendi i Komunës siguron kushte të punës për mbajtje të seancave të Kuvendit të Komunës, si dhe pjesëmarrje për qytetarë gjatë seancave. Siguron transparencë të plotë ndaj qytetarëve për të gjitha vendimet dhe aktet, si dhe për çdo gjë që është në interes të qytetarëve. Po ashtu, iu krijon mundësi qytetarëve që përmes formave të ndryshme të jenë pjesëmarrës në vendimmarrje.

Plani i Punës së Kuvendit të Komunës së Mitrovicës është dokument i mbështetur në Ligjin për vetëqeverisje lokale, Statutin e Komunës, Rregulloren e Punës së Kuvendit dhe aktet tjera nënligjore. Plani është i hartuar në bazë të një kornize logjike i cili planifikon etapat e realizimit të punëve dhe detyrave të Kuvendit të bazuara në detyrat dhe përgjegjësitë që dalin nga Ligji për vetëqeverisje lokale, Statuti dhe aktet tjera nënligjore.

Me këtë plan synohet arritja e objektivave për vitin 2023, ku Kuvendi i Komunës së Mitrovicës planifikon t'i mbaj 11 (njëmbëdhjetë) seanca të rregullta, 6 (gjashtë) prej të cilave në gjashtëmujorin e parë të vitit 2023, në të cilat do të trajtohen të gjitha çështjet që janë në interes të Komunës dhe të qytetarëve të Mitrovicës, e të cilat janë të proceduara sipas akteve në fuqi:

- Cakton datën e mbajtjes së mbledhjeve të rregullta të Kuvendit sipas ligjit dhe rregullores së punës së Kuvendit;
- Themelon Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete sipas ligjit;
- Funksionalizon komitetet e formuara këshillëdhënëse dhe planifikon raportimin e këtyre komiteteve para Kuvendit së paku një herë në vit.
- Planifikon shqyrtimin e raporteve e rregullta të punës së Kryetarit të Komunës sipas ligjit;
- Inkorporon planin e tubimeve me qytetarë të Kryetarit të Komunës;
- Miraton buxhetin, planet investuese, planin vjetor të prokurimit, planin vjetor të punës së auditorit të brendshëm, planet rregullative etj.
- Miraton çështje tjera financiare, të cilat janë të rezervuara për Kuvendin, sipas Statutit apo Rregullores së punës;
- Nxjerr rregullore të reja dhe bënë harmonizimin e rregulloreve ekzistuese me ligjet në fuqi;
- Inkorporon planin e Kryetarit për festa shtetërore e kombëtare.
- Mbikëqyrë, diskuton, analizon dhe vlerëson punën e ekzekutivit;

Përfundim

Plani vjetor i punës së Kuvendit të Komunës, do të ndihmojë dhe lehtësojë punimet e mbledhjeve të Kuvendit, duke iu ofruar anëtarëve të Kuvendit këtë plan, ata do të kenë një pasqyrë për punët dhe aktivitetet e parapara për vitin 2023 e që kanë të bëjnë me interesat e qytetarëve.

Me planin e punës janë paraparë 11 seanca të rregullta, por sipas nevojës mund të mbahen edhe seanca tjera përfshirë edhe seanca të jashtëzakonshme, solemne dhe urgjente, siç parashihet me LVL dhe Statutin e Komunës.

Dinamika e planit të punës së Kuvendit të Komunës do të realizohet në bazë të orarit të mbledhjeve të Kuvendit të miratuar në mbledhjen e parë të Kuvendit në vitin 2023, që përfshin edhe orarin e mbledhjeve të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Kryesuesja e Kuvendit mbanë takime mujore me shefat e grupeve të këshilltarëve të Kuvendit, për të bashkërenditur punën e Kuvendit të Komunës, komiteteve obligative dhe funksionale.

Për përmbushjen e Programit të punës, Ekzekutivi ofron mbështetje profesionale dhe administrative organeve të Kuvendit, duke përshtatur organizimin e brendshëm për realizimin e objektivave dhe agjendës sipas këtij plani.

Për mbarëvajtjen e zbatimit të të gjitha aktiviteteve, sipas dinamikës të përcaktuar me këtë program, do të përkujdesen Kryetari, Kryesuesja e Kuvendit dhe Sekretari i Kuvendit.

Realizimi i Programit të Punës së Kuvendit kërkon bashkërenditje dhe koordinim të aktiviteteve me Ekzekutivin e Komunës, e cila duhet t'i përmbahet planit të Kuvendit për vitin 2023.

Plani i punës së Kuvendit sipas dinamikës mujore përfshinë: emërtimin e aktit, propozuesin, afatin e dërgimit nga propozuesi, afatet e shqyrtimeve nga komitetet funksionale dhe komitetet e përhershme përgjegjëse për shqyrtim.

Programi i Punës së Kuvendit për vitin 2023 do të plotësohet edhe me:

- Miratimin e iniciativave për bashkëpunim ndërkomunal dhe ndërkombëtar.
- Propozime për debate dhe propozime përmbajtjesore,
- Propozime për raportime dhe informata,
- Peticione,
- Pyetje të anëtarëve të Kuvendit.

Shtojcë: Plani i punës sipas muajve

Mitrovicë

Kryesuesja i Kuvendit

Vesa BROJA

Dorëzohet:

1 x 1 Kryesuesit të Kuvendit

1 x 1 MAPL

1 x 1 Arkivit

Kopje: Kryetarit të Komunës

PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË MITROVICËS PËR VITIN 2023

JANAR 2023

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi në KPF	Shqyrtimi në Kuvend	AKTIVITETET
		Dytësor	Parësor				
1.	Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar	Sekretaria e Kuvendit	Kryesuesja e Kuvendit	18.01.2023	25.01.2023	31.01.2023	
2.	Propozim-vendim për caktimin e orarit të mbajtjes së mbledhjeve	Sekretaria e Kuvendit	Kryesuesja e Kuvendit				
3.	Raporti financiar për periudhën janar-dhjetor 2022	Auditori i brendshëm	Kryetari i Komunës				
4.	Informatë e Kryetarit të Komunës lidhur me gjendjen në Mitrovicë pas vërshimeve	Kryetari i Komunës	Kryetari i Komunës				

PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË MITROVICËS PËR VITIN 2023
SHKURT 2023

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak në KPF	Shqyrtimi në Kuvend	AKTIVITETET
		Dytësor	Parësor				
1.	Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar	Sekretaria e Kuvendit	Kryesuesja e Kuvendit	05.02.2023	15.02.2023	28.02.2023	17 Shkurti -
2.	Rishqyrtimi i Projekt rregullore mbi kriteret për vendosje të objekteve të përkohshme në sipërfaqe dhe hapësira publike	DPU	Kryetari i Komunës				Dita e Pavarësisë
3.	Propozim-vendim për caktimin e orarit të mbajtjes së mbledhjeve të rregullta të Kuvendit të Komunës për vitin 2023	Sekretaria e Kuvendit	Kryesuesja e Kuvendit				
4.	Propozim-vendim për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës	DGJKP	Kryetari i Komunës				
5.	Propozim-vendimin për formimin e Komisionit për evidentimin dhe verifikimin e banesave të banimit social	DPU	Kryetari i Komunës				
6.	Projekt Statuti i Qendrës për Punës Sociale	DSH	Kryetari i Komunës				
7.	Plani vjetor i Njësisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2023	NJAB	Kryetari i Komunës				
8.	Plani strategjik i Njësisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2023-2025	NJAB	Kryetari i Komunës				
9.	Raporti i punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2022	Sekretaria e Kuvendit	Kryesuesja e Kuvendit				
10.	Raporti i punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2022	Sekretaria e Kuvendit	Kryesuesja e Kuvendit				
11.	Raporti i punës së Komitetit për Barazi Gjinore për vitin 2022	Sekretaria e Kuvendit	Kryesuesja e Kuvendit				
12.	Raporti i punës së Komitetit për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim për vitin 2022	Sekretaria e Kuvendit	Kryesuesja e Kuvendit				
13.	Raporti i punës së Komitetit për Planifikim Urban, Kadastër, Pronë dhe Mbrojtje të Ambientit për vitin 2022	Sekretaria e Kuvendit	Kryesuesja e Kuvendit				
14.	Raporti i punës së Komitetit për Arsimit, Kulturë, Rini dhe Sport për vitin 2022	Sekretaria e Kuvendit	Kryesuesja e Kuvendit				
15.	Raport i punës së Komisionit Komunal të Aksionarëve të NP “Tregu” për vitin 2022	Komisioni i aksionarëve	Kryesuesja e Kuvendit				
16.	Raport i punës së Komisionit Komunal të Aksionarëve të NP “Stacioni i Autobusëve” – SH.A., për vitin 2022	Komisioni aksionarëve	Kryesuesja e Kuvendit				

PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË MITROVICËS PËR VITIN 2023

MARS 2023

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi Paraprak në KPF	Shqyrtimi në Kuvend	AKTIVIT ETET
		Dytësor	Parësor				
1.	Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar	Sekretaria e Kuvendit	Kryesuesja e Kuvendit	06.03.2023	15.03.2023	29.03.2023	
2.	Raporti i lidhur me proceduarat e udhëhequra dhe kontratat e nënshkruara	Z P	Kryetari i Komunës				
3.	Raport për përfundimin e gjysmë vjetorit të parë të vitit shkollor 2022/2023 përgatitjet për gjysmë vjetorin e dytë	DA	Kryetari i Komunës				
4.	Raport për realizimin i investimeve kapitale	Drejtoritë	Kryetari i Komunës				
5.	Raport për situatën ekonomike-financiare	DEZHTIE DBF	Kryetari i Komunës				
6.	Raporti i punës së Komisionit për ndarjen e bursave	Komisioni	Kryetari i Komunës				
7.	Trajtimi i çështjeve tjera të proceduara për Kuvend nga Kryetari, anëtarët e Kuvendit dhe qytetarët						

PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË MITROVICËS PËR VITIN 2023

PRILL 2023

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak në KPF	Shqyrtimi në Kuvend	AKTIVI TETET
		Dytësor	Parësor				
1.	Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar	Sekretaria e Kuvendit	Kryesuesja e Kuvendit	03.04.2023	12.04.2023	26.04.2023	Dita botërore e Tokës - 22 Prilli
2.	Raporti financiar për periudhën janar-mars 2023	DBF	Kryetari i Komunës				
3.	Trajtimi i çështjeve tjera të proceduara për Kuvend nga Kryetari, anëtarët e Kuvendit dhe qytetarët						

PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË MITROVICËS PËR VITIN 2023

MAJ 2023

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak në KPF	Shqyrtimi në Kuvend	AKTIVITETET
		Dytësor	Parësor				
1.	Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar	Sekretaria e Kuvendit	Kryesuesja e Kuvendit	08.05.2023	16.05.2023	31.05.2023	
2.	Plani i Veprimit për Dëgjimet publike - Informatë Qarkorja buxhetore për vitin 2023	DBF	Kryetari i Komunës				
3.	Raport për gjendjen sociale në Komunë	DMSIE	Kryetari i Komunës				
4.	Raport mbi planifikimin dhe realizimin e mbjelljeve pranverore	DBZHR	Kryetari i Komunës				
5.	Raport lidhur me mirëmbajtjen dimërore të rrugëve	DSHPI	Kryetari i Komunës				
6.	Informatë rreth gjendjes shëndetësore të qytetarëve të Komunës së Mitrovicës	DSH	Kryetari i Komunës				
7.	Trajtimi i çështjeve tjera të proceduara për Kuvend nga Kryetari, anëtarët e Kuvendit dhe qytetarët						

PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË MITROVICËS PËR VITIN 2023

QERSHOR 2023

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak në KPF	Shqyrtimi në Kuvend	AKTIVITE TET
		Dytësor	Parësor				
1.	Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar	Sekretaria e Kuvendit	Kryesuesja e Kuvendit	06.06.2023	14.06.2023	28.06.2023	Manifestimi Ditët e Kulturës - qershor - korrik Tubim me qytetar,
2.	Korniza Afatmesme Buxhetore 2023/2025	DBF drejtoritë	Kryetari i Komunës				
3.	Raport për gjendjen në Shëndetësi	DSH	Kryetari i Komunës				
4.	Raport mbi gjendjen në lëmin e Sportit dhe Rinisë	DKRS	Kryetari i Komunës				
5.	Raporti vjetor i menaxhimit të mbeturinave	DMM	Kryetari i Komunës				
6.	Shqyrtimi i raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2022		Kryetari i Komunës				
7.	Raport i Zyrës - Njësisë për të Drejtat e Njeriut dhe Zyrës për Barazi Gjinore	DBF	Kryetari i Komunës				
8.	Raport mbi gjendjen në lëmin e Kulturës në Komunë	DKRS	Kryetari i Komunës				
9.	Trajtimi i çështjeve tjera të proceduara për Kuvend nga Kryetari, anëtarët e Kuvendit dhe qytetarët						

PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË MITROVICËS PËR VITIN 2023

KORRIK 2023

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak në KPF	Shqyrtimi në Kuvend	AKTIVITE TET
		Dytësor	Parësor				
1.	Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar	Sekretaria e Kuvendit	Kryesuesja e Kuvendit	04.07.2023	12.07.2023	26.07.2023	
2.	Raport gjashtëmuor për zhvillimin ekonomik të Komunës	DEZHTIE	Kryetari i Komunës				
3.	Raporti financiar janar-qershor 2023	DBF drejtoritë	Kryetari i Komunës				
4.	Raport lidhur me kërkesat për investime kapitale nga dëgjimet publike dhe inkorporimi në propozim-buxhet për vitin 2022	DBZHR	Kryetari i Komunës				
5.	Raport për përfundimin e vitit mësimor 2022/2023 dhe përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor 2023/24	DA	Kryetari i Komunës				
6.	Raport për dinamikën e realizimit të investimeve kapitale për periudhën janar-qershor 2023	DSHPI	Kryetari i Komunës				
7.	Raporti i Komisionit Komunal të Aksionarëve të NP "Qendra Multifunkionale"	Komisioni i aksionarëve	Kryetari i Komunës				
8.	Raporti i Komisionit Komunal të Aksionarëve të NP "Tregu"	Komisioni i aksionarëve	Kryetari i Komunës				
9.	Raporti i Komisionit Komunal të Aksionarëve të KRRU "Uniteti"	Komisioni i aksionarëve	Kryetari i Komunës				
10.	Raporti i Komisionit Komunal të Aksionarëve të NP "Stacioni i Autobusëve"	Komisioni i aksionarëve	Kryetari i Komunës				
11.	Raport lidhur me punën e Drejtorisë së Prokurimit dhe proceduarat që janë kryer (janar-qershor 2023)		Kryetari i Komunës				
12.	Trajtimi i çështjeve tjera të proceduara për Kuvend nga Kryetari, anëtarët e Kuvendit dhe qytetarët						



PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË MITROVICËS PËR VITIN 2023

GUSHT 2023

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak	Shqyrtimi në Kuvend	AKTIVITE TET
		Dytësor	Parësor				
1.							
2.							
3.							
4.							
5.							
6.							
7.							
8.							
9.							
10.							
11.							

PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË MITROVICËS PËR VITIN 2023

SHTATOR 2023

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak në KPF	Shqyrtimi në Kuvend	AKTIVITETET
		Dytësor	Parësor				
1.	Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar	Sekretaria e Kuvendit	Kryesuesja e Kuvendit	04.09.2023	13.09.2023	27.09.2023	Manifestimi letrar "Drita e Minatorit"
2.	Miratimi i buxhetit për vitin 2024 dhe parashikimi për vitet 2025-2026 (Qarkorja buxhetore dhe Raporti i dëgjimeve buxhetore)	DBF drejtoritë	Kryetari i Komunës				
3.	Miratimi i vendimit për tatimin në pronë për vitin 2024	DBF drejtoritë	Kryetari i Komunës				
4.	Raport lidhur me zbatimin e vendimeve (kontratave) të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës në Zonën e lirë ekonomike (neni 11 i LZE)	KGJKP	Kryetari i Komunës				
5.	Raport lidhur me zbatimin e vendimeve (kontratave) të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës (neni 22 i LDHSHPPK)	KGJKP	Kryetari i Komunës				
6.	Propozim-vendim për ndarjen e bursave për studentë	DAP	Kryetari i Komunës				
7.	Propozim-vendim për formimin e Komisionit për ndarjen e bursave	DAP	Kryetari i Komunës				
8.	Propozim-vendim për formimin e Komisionit të Ankesave për ndarje të bursave	DAP	Kryetari i Komunës				
9.	Draft-Rregullore Komunale për përkujdesjen dhe mbrojtjen e Fëmijës	Grupi Punues	Kryetari i Komunës				
10.	Trajtimi i çështjeve tjera të proceduara për Kuvend nga Kryetari, anëtarët e Kuvendit dhe qytetarët						

TETOR 2023

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak në KPF	Shqyrtimi në Kuvend	AKTIVITETET
		Dytësor	Parësor				
1.	Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar	Sekretaria e Kuvendit	Kryesuesja e Kuvendit	02.10.2023	11.10.2023	25.10.2023	
2.	Raport për realizimin e projekteve dhe subvencioneve të DBZHR	DBZHR	Kryetari i Komunës				
3.	Raporti përfundimtar i Komisionit komunal mbi korrje-shirjet	DBF drejtoritë	Kryetari i Komunës				
4.	Raporti për zbatimin e Planit të Integritetit	DAP	Kryetari i Komunës				
5.	Raport për zbatimin e Planit Trevjeçar të Banimit	DMS DPU	Kryetari i Komunës				
6.	Projekt-Plani Operativ Emergjent për Komunë	DMM	Kryetari i Komunës				
7.	Raport i DAP për përgatitjet për ofrimin e shërbimeve për qytetarë në gjendjen civile gjatë sezonës së verës	DAP	Kryetari i Komunës				
8.	Raporti financiar për periudhën korrik-shtator 2023	DBF	Kryetari i Komunës				
9.	Trajtimi i çështjeve tjera të proceduara për Kuvend nga Kryetari, anëtarët e Kuvendit dhe qytetarët						

NËNTOR 2023

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak në KPF	Shqyrtimi në Kuvend	AKTIVITETET
		Dytësor	Parësor				
1.	Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar	Sekretaria e Kuvendit	Kryesuesja e Kuvendit	06.11.2023	15.11.2023	29.11.2023	Dhënia e Çmimit “Kadri Kadriu” - 28 Nëntor
2.	Propozim-vendim për formimin e Jurisë profesionale për ndarjen e çmimit “Kadri Kadriu”	DKRS	Kryetari i Komunës				
3.	Propozim Vendim - Për miratimin paraprak të listës së përgjithshme të pronave të paluajtshme si dhe listën e veçantë të pronave të cilat planifikohen për dhënie në shfrytëzim apo këmbim nw vitin 2024	DGJKP	Kryetari i Komunës				
4.	Propozim-vendim për formimin e Komisionit për ndarjen e çmimit “Lah Nimani”	DKRS	Kryetari i Komunës				
5.	Raport i DAP -Zyrës për Barazi Gjinore	DAP	Kryetari i Komunës				
6.	Informatë mbi gjendjen e Bujqësisë në Komunë	DBZHR	Kryetari i Komunës				
7.	Raport i DAP - Njësisë për të Drejtat e Njeriut	DAP	Kryetari i Komunës				
8.	Raporti për zbatimin e planit të veprimit në mjedis	DMM	Kryetari i Komunës				
9.	Informatë për procesin e Legalizimit	DPU	Kryetari i Komunës				
10.	Trajtimi i çështjeve tjera të proceduara për Kuvend nga Kryetari, anëtarët e Kuvendit dhe qytetarët						

DHJETOR 2023

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak në KPF	Shqyrtimi në Kuvend	AKTIVITETET
		Dytësor	Parësor				
1.	Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar	Sekretaria e Kuvendit	Kryesuesja e Kuvendit	06.12.2023	15.12.2023	29.12.2023	Dhënia e Çmimit "Lah Nimani"
2.	Propozim-buxheti i NTP "Stacioni i Autobusëve" dhe Plani i biznesit për vitin 2023 (neni 25 LVL)	Komisioni i aksionareve	Kryetari i Komunës				
3.	Propozim-buxheti i KRM "Uniteti" dhe Plani i biznesit për vitin 2023 (neni 25 LVL)	Komisioni i aksionareve	Kryetari i Komunës				
4.	Propozim-buxheti i NTP "Qendra Multifunkionale" dhe Plani i biznesit për vitin 2023 (neni 25 LVL)	Komisioni i aksionareve	Kryetari i Komunës				
5.	Propozim-buxheti i NTP "Tregu" dhe Plani i biznesit për vitin 2023 (neni 25 LVL)	Komisioni i aksionareve	Kryetari i Komunës				
6.	Trajtimi i çështjeve tjera të proceduara për Kuvend nga Kryetari, anëtarët e Kuvendit dhe qytetarët	drejtoritë	Kryetari i Komunës				